



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1259/ 1 prot

Datë 19.05.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “C.C.S SHPK në procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”*, me Nr. REF-34996-12-31-2024, me objekt *“Ristrukturim i Disaster Recovery Site”*, me fond limit 30.246.506,67 (tridhjetë milion e dyqind e dyzet e gjashtë mijë e peseqind e gjashtë presje gjashtedhjetë e shtatë) lekë pa tvsh. Vlera e fondit Limit në monedhen ndërkombetare Euro sipas kursit të Bankes së Shqipërisë është 308.166,14 (treqind e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje katërmëdhjetë) euro pa TVSH. Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes të Shqipërisë datë 31.12.2024 është 98.15 euro., zhvilluar me datë 12.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.
- Ankimues:** Operatori ekonomik *“Advanced Business Solutions ABS”* SHPK me NIPT K21710002J me adresë: Rruga “Murat Toptani”, Godina Eurocol, Kati. 8, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a..
Adresa: Rruga “Kavajës”, Ndërtesa nr. 133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë.
- Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “C.C.S SHPK me NIPT J61901033C, me Adresë: Rruga “Sulejman Delvina”, Nr. 8, Kodi Postar nr.1019, Tiranë.

Në datën 14.05.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5315 dhe me numer 1259/2025 prot, datë 14.05.2025 e operatorit ekonomik *“Advanced Business Solutions ABS”* SHPK për procedurën e *“Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”*, me Nr. REF-34996-12-31-2024, me objekt *“Ristrukturim i Disaster*

Recovery Site”, me fond limit 30.246.506,67 (tridhjetë milion e dyqind e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtë presje gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh. Vlera e fondit Limit në monedhen nderkombetare Euro sipas kursit të Bankes së Shqipërisë është 308.166,14 (treqind e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje katërmëdhjetë) euro pa TVSH. Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes të Shqipërisë datë 31.12.2024 është 98.15 euro., zhvilluar me datë 12.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomikë “C.C.S” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërmat “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriteret për të cilat ankimuesi pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “C.C.S” SHPK pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Operatori ekonomik “C.C.S SHPK nuk plotëson kriteret si mëposhtë:

Pikën 2.3.1 “Kapaciteti Teknik”

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara, ose,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara.

Gjithashtu operatori ekonomik ankimes ngren pretendimin për operatim ekonomik “C.C.S” SHPK si më poshtë vijonë:

Mungon zgjidhje e plote per sistem Monitorimi, Kontrolli dhe Menaxhimi (BMS). Sipas kërkesave teknike te percaktuara ne dokumentet e tenderit, kerkohet nje sistem i Monitorimit, Kontrollit dhe Menaxhimit.

Per sa me siper, kerkojme qe te merret ne shqyrtim te metejshe dhe te behet rivleresimi i sistemit te Monitorimit, Kontrollit dhe Menaxhimit te ofruar nga operatori ekonomik C.C.S. Rivleresimi do te ndihmonte ne verifikimin e perputhshmerise 100% te ofertes me kërkesat teknike te percaktuara ne dokumentacionin e tenderit.

Dyshemeja teknologjike e ofruar nuk eshte ne perputhje te plote me kërkesat teknike te projektit. Kërkesat per dyshemene teknologjike te specifikuara ne projekt, te cilat perfshijne pllakat, grilat, si dhe strukturen mbajtese te dyshemese, jane teper specifike per modelin e dyshemese teknike te posaçme, qe ka kerkuar AK per dhomen e servereve. Prodhuesit e ketij modeli jane kontaktuar nga ana jone dhe sipas informacioneve te tyre, shprehim me siguri te plote se nuk ka pasur kërkesa per ofrimin e dyshemeve te tilla per klientin fundor, UKT. Ne baze te kesaj, pretendojme se operatori ekonomik C.C.S. nuk ka ofruar dyshemene e duhur per kete procedure. Ju lutemi te verifikoni edhe nje here modelin e dyshemes se ofruar nga ky operator, duke u siguruar qe te gjitha kërkesat jane plotesisht te permbushura sipas datasheet-it te prodhuesit te dyshemes se ofruar.

Kerkojme te behet nje rivleresim i ofertes teknike te operatorit ekonomik “C.C.S.” shpk duke verifikuar me perpikeri permbushjen e te gjitha kërkesave teknike te percaktuara per kete produkt ne kete procedure.

Dera zjarrrdurese e ofruar nuk eshte ne perputhje te plote me kërkesat teknike te projektit. Kërkesa e AK per furnizimin dhe instalimin e nje derezjarrrdurese eshte e nje tipi specifik qe perdoret vetem per ambiente te tilla infrastrukturash IT. Prodhuesi i vetem qe operon ne Shqiperi per keto lloje produktesh eshte kontaktuar nga ana jone dhe sipas konfirmimit te tij, shprehim me siguri te plote se nuk ka pasur kërkesa per dera zjarrrdurese te tille per klientin fundor, UKT. Ne baze te kesaj, pretendojme se operatori ekonomik C.C.S. nuk ka ofruar asnje zgjidhje teknike per kete kërkesa dhe as ndonje “Data Technical Sheet” ne kete procedure.

Kerkojme te behet nje rivleresim i ofertes teknike te operatorit ekonomik “C.C.S.” shpk, duke verifikuar me perpikeri permbushjen e te gjitha kërkesave teknike te percaktuara ne kete procedure per kete produkt.

Ne piken 11 te Kapitullit “Specifikimet Teknike” ne DT, AK ka kerkuar: Per panelin elektrik ofertuesi duhet te paraqese projektet dhe skemat elektrike te detajuara, si dhe projektet e instalimeve ne permasa reale per te shmangur çdo lloj problemi qe mund te dale per shkak te hapësirës ose mosfunksionimit te sistemit. Sic e kemi shprehur me lart, duke njohur aftesite dhe kapacitet e ketij OE ne kete fushe, konfirmojme me siguri te plote se ne kete procedure

nuk mund të jehë paraqitur kurrësi projekte dhe skema elektrike të detajuara, sic kërkohet nga AK. Një kërkesë e tillë nuk mund të jetë plotësuar kurrësi.

Kërkohet të bëhet një rivelesim i ofertës teknike të operatorit ekonomik “C.C.S” shpk, duke verifikuar me përpikëri plotësimin e kërkesës së AK për dorëzimin e projekteve dhe skemave elektrike të detajuara, si dhe projektet e instalimeve në permassa reale.

Kërkohet të bëhet një rivelesim i ofertës teknike të operatorit ekonomik “C.C.S”, duke verifikuar me përpikëri plotësimin e kërkesës së AK për produktin cilindër dhe agjent shuës dhe dorëzimin e “Data Technical Sheet”.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 19.05.2025

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri